



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 14, datë 14.10.2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAOËSOR PËR UJË TË PIJSHËM PËR >2l/sek”,
SUBJEKTIT “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SH.A.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) për >2l/sek, subjektit “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a, me vendndodhje, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Rezervuari i Bovillës.

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH)

- X=488849
- Y=4589984
- Z=307 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: 1800 l/sek
Prurja llogaritëse: 3600 l/sek
Prurja mesatare vjetore: 3140 l/sek
Prurja ekologjike: 93 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU ISHËM

ROLAND NASTO

